



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

për të ndjekur kursin: “Studentët, Universiteti dhe Proceset e Ballafaqimit me të Kaluarën në Kosovë”

Përmes kësaj thirrje, Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës fton studentët që të aplikojnë për pjesëmarrje në kursin “Studentët, Universiteti dhe Proceset e Ballafaqimit me të Kaluarën në Kosovë”.

Qëllimi i këtij kursi është t'u prezantojë studentëve fushën e drejtësisë tranzicionale si një rrugë e trajtimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën dhe si një fushë që kontribuon në procesin e pajtimit dhe demokratizimit në shoqëritë post-konfliktuale dhe post-autoritare.

Kursi ngritë besimin dhe rrit njohuritë e studentëve të Kosovës në përgjithësi për adresimin e së kaluarës dhe ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme.

Rezultatet e pritura.

Në fund të kursit pjesëmarrësit:

- Do të jenë në gjendje të kuptojnë konceptin e drejtësisë tranzicionale;
- Të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë pjesë aktive dhe pozitive në çështjet e drejtësisë tranzicionale dhe ndërtimit të paqes;
- Të fitojnë njohuri të thelluara për rastet e ndryshme të vendeve që kanë kaluar në procesin e drejtësisë tranzicionale në nivel rajonal dhe ndërkombëtar;
- Do të jenë kompetent për të transferuar njohuritë dhe aftësitë e fituara në mjedisin e tyre personal dhe profesional;
- Do të njihen me mundësitë e karrierës në fushën e drejtësisë tranzicionale;
- Të kenë një kuptim më të qartë të proceseve aktuale të drejtësisë tranzicionale në Kosovë.

Pas përfundimit të ligjëratave, studentët do të marrin pjesë në një konferencë ndërkombëtare që do të organizohet në ambientet e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Numri i pjesëmarrësve në kurs është i kufizuar në 35 pjesëmarrës dhe kujdes i veçantë do ti kushtohet pranimit të pjesëmarrësve me përfaqësim proporcional të gjinisë si dhe pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike. Studentët që vijnë nga grupet e komuniteteve pakicë inkurajohen të aplikojnë.

Kursi do të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe angleze.

Do të zgjasë dy muaj dhe është pa pagesë.

Studentët në fund do të pajisen me certifikatë.

Ky aktivitet është iniciuar nga Qendra për të Drejtat e Njeriut e Universitetit të Prishtinës, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në kuadër të “HERAS+, Arsimit të Lartë, Hulumtimit dhe Shkencës së Aplikuar Plus”.

Të gjithë studentët e interesuar duhet të dërgojnë CV-në dhe një letër motivimi në email adresën: hrc-up@uni-pr.edu, me titull "Kursi i Drejtësisë Tranzicionale"

Afati i fundit për aplikim: E diel, 1 maj 2022, ora 18:00.

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të informohen përmes emailës më 3 maj 2022.